



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 1733 Prot

Gjirokastrë, më 11 . 11 . 2024

Lënda: Hapen thirrjet për shkrim projekt propozimesh në kuadër të programit *The Interacademy Partnership (IAP)*.

Në kuadër të Programit *The Interacademy Partnership (IAP)*, janë hapur thirrje të reja për projekt propozime, si vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	The Interacademy Partnership (IAP)	02 dhjetor 2024

Thirrja për projekt propozime në kuadër të patneritetit ndërmjet akademive (IAP), fton për aplikime akademitë dhe rrjetet rajonale të kërkimit shkencor, apo dhe institucione të arsimit të lartë të cilat në bashkëpunim me akademitë e shkencave të vendeve përkatëse mund të aplikojnë për projekte që do të kontribuonin në avancimin e misionit dhe qëllimeve të IAP.

Prioritet në këtë thirrje do të kenë projekte të cilat synojnë të krijojnë ose të thellojnë bashkëpunimin midis disiplinave të ndryshme, si bashkëpunime ndërmjet akademive të shkencave, mjeksisë dhe inxhinierisë, veçanërisht projekte që përfshijnë akademitë e reja të sapo krijuara, si në vendet me të ardhura të larta, po ashtu edhe në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

Kriteret kryesore që duhet të përmbushen gjatë aplikimit të një projekt propozimi:

- Projekt propozimi duhet të aplikohet nga aplikanti kryesor, i cili është anëtar i akademisë ose i rrjetit të IAP.
- Propozimet mund të dorëzohen nga një akademi e vetme ose një rrjet rajonal në bashkëpunim me akademitë e tjera anëtare të IAP ose rrjetet rajonale.
- Prioritet do të kenë projektet që demostrojnë dhe kontribuojnë në krijimin e patneriteteve të qëndrueshme.

- Për projektet e aplikuara nga disa patnerë, natyra e kontributit dhe roli i secilit patner duhet të përshkruhet sa më qartë.
- Buxheti i kërkuar nga IAP nuk mund të jetë më shumë se 50.000 USD.
- Kohëzgjatja e aktiviteve të propozuara nuk duhet të kalojë 12 muaj.

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin e *The Interacademy Partnership (IAP)* (<https://www.interacademies.org/publication/iap-releases-its-strategic-plan-2024-2026/>).

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv/Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj

